Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1061

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "AS Tech SH.P.K." kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjore" me nr. të prokurimit: "33600-23-12202-2-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Shërbimi Korrektues i Kosovës, më 26/02/2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "AS Tech Sh.P.K." me nr. 2023/1061 , e datës 28.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjore" me nr. të prokurimit: "33600-23-12202-2-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues Shërbimi Korrektues i Kosovës.

2. Vërtetohet vendimi i AK për dhënie për aktivitetin e prokurimit i përshkruar si në piken I të diapozitivit të këtij vendimi.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04/11/2023, Shërbimi Korrektues i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te

Mjekësisë Ligjore". Ndërsa me datën 08/12/2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Liria Sh.P.K".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 43,000.00 €.

Me 13/12/2023, OE "AS Tech Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AS Tech Sh.P.K." me nr. 1061/23 lidhur me aktivitetin "Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjore" me nr. të prokurimit: "33600-23-12202-2-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"AS Tech Sh.P.K."., janë parashtruar si në vijim**:**

Sqarim Hyrës : "Parashtrojmë këtë Ankese kundër Vendimit te AK-se lidhur me aktivitetin Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorve në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Instituti të Mjekësisë Ligjore me nr. 33600-23-12202-2-2-1, ku AK nga dy oferta e dorëzuara shpërblen me kontrate ofertën e OE LIRIA ShPK, e cila nuk është e përgjegjshme. Vlerësimin tone e bazojmë nga qasja qe kemi pasur ne ofertën e rekomanduar ku te gjeturat tona do ti paraqesim ne dy pretendime.

Pretendimi i parë (I) : "AK e shpërblen një oferte qe nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit, OE nuk e ka plotësuar "1. Operatori Ekonomik duhet te këtë të kryer me sukses te paktën një (01) kontratë ne tri vitet e shkuara para publikimit te njoftimit për kontratë për shërbime te ngjashme". ne ofertën e tij përkatësisht ne liste te kontratave askund nuk ka kontrata te natyrës se ngjashme, OE ka kontrata te Furnizimeve te ndryshme qe përveç qe nuk janë servisime nuk janë as te natyrës se gjeneratoreve. Te vetmen reference e ka sjell me Komunën e Podujevës për kontratën me titull "Mirëmbajtja dhe riparimi i energjisë elektrike ne institucionet komunale" e cila ka disa pozicione për gjeneratora, por komisioni i vlerësimit nuk e ka bere vlerësimin e drejte te tenderit sepse e ka pranuar Listën e kontratave dhe këtë kontrate te vlefshme duke mos e respektuar Kërkesën e dosjes qe OE te sjell dëshmi te paktën një kontrate te natyrës se ngjashme. Është e vërtetë qe OE ka ne kontrate me Podujevën disa pozicione por ato janë vetëm disa pozicione madje edhe me çmim për njësi, ndërsa Kontrata është e natyrës se elektrikes. OE nuk e ka plotësuar kërkesën qe te këtë te paktën një kontrate për Servisim te gjeneratoreve, OE te vetmen dëshmi e ka te natyrës se Elektrikes. Komisioni i vlerësimit dhe AK ne përgjithësi nuk ka vlerësuar si duhet tenderin sepse nuk ju ka përmbajtur kërkesave te dosjes, sepse natyra

e elektrikes nuk është aspak e ngjashme me servisim te gjeneratoreve, këtë shërbim e bëjnë serviserat e specializuar ne këtë fushe, mekanik te kësaj fushe, prandaj është e papranueshme si nga ana funksionale po ashtu edhe nga vete përshkrimi i kontratës dhe Listës se kontratave qe OE Liria ka sjell. Decidivisht OE nuk ka kontrate te përfunduar te natyrës se servisimit te gjeneratoreve dhe si rrjedhoje nuk e ka plotësuar si duhet këtë kërkesë te dosjes se tenderit. Mos plotësimi i këtij kriteri e bene ofertën e papërgjegjshme sepse është kriter i kapacitetit teknik te dosjes qe përveç qe nuk është plotësuar, AK bene gabim kur nuk i përmbahet kritereve te vendosura nga vete ai, dhe e pranon një kontrate te elektrikes se te vlefshme..”

*Pretendimi i dytë (II): “*AK ka shpërblyer një oferte qe ka sjell çmime te njëjta për çdo gjenerator, e kemi fjalën për pozicionin nr. 40- Pompa e vajit - komplet- € 490.00.per secilin prej gjeneratoreve. E parashtrojmë këtë pretendim për shkak se AK ka bere vlerësim subjektiv, OE LIRIA ja ka pranuar çmimet e njëjta për te gjitha gjeneratoret, ndërsa ofertës tone ne tenderin me nr. 616-23-6416-221(aktivitet paraprak i anuluar për këtë shërbim) e eleminon me arsyen se sipas AK-se nuk është e mundur qe te gjitha gjeneratorët te kenë madhësinë e njëjtë dhe çmimin e kostos se njëjtë. Këto janë fjalët dhe arsyetimi qe AK na e ka dhënë ne Letrën standared për eleminim, ndërsa OE Liria e shpërblen ndonëse ne paramase ka dhe çmim te njëjtë 490 për çdo gjenerator ne pozicionin nr. 40. Për ta dëshmuar vlerësimin tuaj subjektiv por ju bashkangjesin Prove - vendimin e AK-së te tenderit te kaluar ne nr., 616-23-6416-221 për Servisim me mirëmbajtje te gjeneratoreve dhe arsyeshmerine e eleminimit te ofertës tone te nënvizuar me ngjyre te kaltër. Vlerësojmë bindshëm se AK nuk e ka bere si duhet vleresim e tenderit, AK ne mënyrë tendencioze ka përdorë standarde te dyfishta për vlerësimin e tenderit te këtij shërbimi, për te njëjtin kriter vlerëson ndryshe dy oferta, dhe kjo ska si te jete ndryshe përveç shkelje e ligjit te prokurimit publik. ky aktivitet me këtë shërbim është tenderuar dhe anuluar 3 here brenda këtij viti, arsyet e anulimit kane qene gjithmonë te ndryshme vetëm me qellim te mos shpërblimit te kompanisë tone e cila gjithmonë ka qene e vetmja pjesëmarrëse ne këtë aktivitet. Prandaj po e cekin se arsyet qe kompaninë tone e ka eliminuar ne aktivitetet paraprake janë ato qe OE i rekomanduar ne këtë aktivitet i ka te njëjta por këtë nuk e eliminon vetëm me qellim qe mos te kaloj dhe te shpërblej ofertën tone.”

Pretendimi i tretë (III):“ AK ka për detyre shqyrtimin e te gjitha pretendimeve te parashtruara ne Kërkesën për rishqyrtim, ndërsa ne këtë rast ne kërkesën tone për rishqyrtim nuk është shqyrtuar aspak pretendimi 2 i kërkesës për rishqyrtim. përveç qe është një bindje edhe me e madhe se as vete AK ska dite se si te arsyetoj shkeljen e vete për trajtim te ndryshëm te rasteve te njëjta, AK bene shkelje te ligjit edhe kur nuk e aprovon ose refuzon një pretendim, thjeshte nuk është marr aspak me te. Mos shqyrtimi i një pretendimi është njësoj se mos shqyrtimi i tere kërkesës për rishqyrtim sepse OE ka te drejte te sqarimeve ne pika ose pretendime te caktuara dhe jo AK ta shqyrtoj me një përmbledhje te përgjithshme si "refuzohet kërkesa për rishqyrtim", sepse po nënkuptohet se AK nuk po i mbron pretendimet me sqarime por ne fakt po e mbron Vendimin e saj tendencioz. Përfundimisht ju sqarojmë se ka shume fakte se AK nuk ka qene objektive ne vlerësim, pastaj janë shpallur dhe anuluar shume e shume procedura te këtij shërbimi vetëm qe mos te shpërblehet oferta jone e vetme, ne e dimë qe AK është treguar subjektive ne këtë rast dhe raste tjera por dëshirojmë te jemi profesional dhe te ndalemi dhe te shqyrtojmë pikat vetëm te këtij aktiviteti. “

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “AS Tech SH.P.K.”., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin Neni 7, 59, dhe 60 të LPP-Së . Duke kërkuar nga OSHP që ta shqyrtoj ankesën tone, rrjedhimisht kthim te lendes ne rivlerësim sepse konsiderojmë se jemi oferta e vetme e përgjegjshme.

Përgjigja e AK ne ndaj kërkesës për rishqyrtim: “ Si Autoritet Kontraktues, Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) me datën 04.11.2023 ka Ri tenderuar (RITENDER 3) në procedure të hapur aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi he mirembajja e gjeneratoreve ne institucionet e Sherbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjor", me numër te prokurimit: 33600-23-1742-2-2-1 sipas Nenit 40 te Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar the plotësuar me Ligjin Nr. 04/1-237 Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Ne procesin e hapjes me date 20.11.2023 kemi pranuar vetëm dy (2) oferta për këtë aktivitet të prokurimit. Komision i vlerësimit pasi ka bere vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ka ardhur ne përfundim se operatori ekomomik ka dorëzuar oferta te papërgjegjshme. Me date 24.04.2023 kemi pranuar ankesat/kërkesë për rishqyrtim te vendimit te AK-SHKK për dhënje të kontratës, me pretendimin se janë shkelur: Neni 6 i LPP-së, Neni 7 i LPP-së, Neni 59 i LPP-se, Neni 60 i LPP-së. Pas pezullimit te këtij aktiviteti me date 14.12.2023, sipas dispozitave ligjore te LPP-se te nenit 108/A, dhe ne përputhje me rregullat për parashtrimin e ankesave te nxjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pikat e ankesës duke konstatuar se: Pika e ankesës lidhur me nenin 6 te LPP-se, nuk qëndron pasi AK - SHKK ka siguruar që fondet publike dhe burimet publike janë duke u përdorë ne mënyrën më ekonomike, njëkohësisht kemi marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. Komisioni i vlerësimit e ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin ekonomik qe ka ofertën me çmimin me te lire. Pika e ankesës lidhur me nenin 7 te LPP-s nuk qëndron pasi AK-SHKK ka bere vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ne mënyre te argumentuar, te drejte dhe korrekte duke trajtuar te gjithë OE pjesëmarrës ne mënyre te barabarte duke vlerësuar me kujdes te gjithë dokumentacionin e dorëzuar ne plotësimin e secilës kërkesë dhe kriter ne dosje, prandaj ka konstatuar edhe një here se oferta ankuese nuk është me çmim me te lire dhe se është mbi vlerën e parashikuar te kontratës. Pika e ankesës lidhur me nenin 59 te LPP-së, nuk qëndron pasi AK - SHKK ka bere vlerësimin e ofertave sipas nenit 59 dhe neneve tjera te LPP-se. Kriter i vlerësimit ka qene se operatoret ekonomik konkurrues duhet te kenë te kryer me sukses te paktën një (01) kontrate ne tri vitet e shuara para publikimit te njoftimit për kontrate për shërbime te ngjashme. Pra për shërbime te ngjashme jo identike. Ashtu siç e keni potencuar edhe ju ne kërkesën për rishqyrtim operatori ekonomik i rekomanduar për dhënien te kontratës e ka ofruar referencën me Komunën e Podujevës për kontratën me titull: "Mirëmbajtja dhe riparimi i energjisë elektrike ne institucionet komunale" e cila ka disa pozicione për gjenerator.

Komisioni i ka versuar se është kontrate e natyrës se ngjashme. As kund ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nuk është përmendur fjala “kontrate te përfunduar te natyrës se servisimit te gjeneratorëve”, por shënon “kontrate për shërbime te ngjashme”. Te bashkangjitur gjeni pjesën e servisimit te gjeneratorëve qe e ka dorëzuar OE për servisimin e gjeneratorëve ne Komunën e Podujevës.” Neni 60 Kriteret për Dhënjen e Kontratës, nder te tjera thotë: "Autoriteti kontraktues do tia jap kontratën publike operatorit ekonomik qe ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulet". Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës e ka ofertën me te lire se oferta e juaj dhe e ka nen vlerën e parashikuar te kontratës. Oferta e juaj është me e larte ne aspektin financiar si pe pjesa e pare gjithashtu edhe te pjesa e dyte. Ju e din se oferta e juaj nuk mundet te shpërblehet me kontrate pasi ju keni ofertën me çmim me te larte dhe e keni mbi vlerën e parashikuar te kontratës. Bazuar ne vendimin e OSHP nr. 2023/0271 ju nuk mundeni te shpërbleheni me kontrate edhe nëse lënda kthehet ne rivlerësim. Prandaj sipas dispozitave ligjore te LPP-se te nenit 108/A, dhe ne përputhje nenin 8.1.1 pika (ii) te rregullave për parashtrimin e ankesave te ngjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues e refuzon kërkesën e propozuar për shqyrtim si te pabaze sikurse ne dispozitiv te këtij vendimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1061/23, ndërsa me datë 07.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/1061 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues,Ndërsa OE nuk Pajtohet rreth rekomandimeve te ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AS Tech Sh.P.K."eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1061 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: **"**Parashtruesi i ankesës – OE "As Tech" (më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 13.12.2023, për të cilën AK me datë 18.12.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim."

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1 : "AK me datë 08.12.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin ku është rekomanduar për kontratë OE "Liria" me çmimin e ofertës prej 40,249.64 euro. I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues me datë 13.12.2023, ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimin e njëjtë ankimor. AK me datë 18.12.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku ka dhënë arsyetimin lidhur me këtë pretendim si vijon: "Ashtu siç e keni potencuar edhe ju ne kërkesën për rishqyrtim operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës e ka ofruar referencën me Komunën e Podujevës për kontratën me titull: Mirëmbajtja dhe riparimi i energjisë elektrike ne institucionet komunale" e cila ka disa pozicione për gjenerator. Komisioni i ka vlerësuar se është kontratë e natyrës se ngjashme. Askund ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë nuk është përmendur fjala "kontratë te përfunduar te natyrës se servisimit te gjeneratorëve", por shënon "kontratë për shërbime te ngjashme". Te bashkangjitur gjeni pjesën e servisimit te gjeneratorëve qe e ka dorëzuar OE për servisimin e gjeneratorëve ne Komunën e Podujevës." AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si

vijon: “1. Operatori Ekonomik duhet te ketë të kryer me sukses te paktën një (01) kontratë ne tri vitet e shkuara para publikimit te njoftimit për kontratë për shërbime te ngjashme”. Dëshmia e kërkuar dokumentare për këtë kërkesë është: 1. Listën e kontratave për tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë. 1.1 Minimum një (01) referencë për shërbimet te ngjashme, referenca të realizuara me suksese. Referencë kur shërbimet janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashke nënshkruara nga autoriteti i tillë. Kur shërbimi është bërë për një Operator Ekonomik privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga marrësi i shërbimeve dhe evidentimi i livrimit të tillë." OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e kontratave ku janë paraqitur 101 kontrata. Në bazë të informatave të prezantuara në listën e kontratave, 60 kontrata janë të përfunduara brenda periudhës prej tre viteve të fundit nga njoftimi për kontratë (04.11.2023). Po ashtu është dorëzuar edhe referenca e lëshuar me datë 04.01.2023 nga AK-Komuna e Podujevës në lidhje me kontratën "Mirëmbajtja dhe riparimi i energjisë elektrike në Institucionet komunale" me numër të prokurimit "615-21-2108-2-2-1". Eksperti sqaron se në lidhje me formulimin kontrata të ngjashme, KRPP ka dhënë opinionin numër 11 me datë 09.06.2023, si vijon: " Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë: OPINION: Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj. Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme. Në kuptim të prokurimit publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës. Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së). Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: “Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara.....” Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet “të njëjta” apo “të ngjashme”. Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: “Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se

cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këto rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik."

*Konstatimi i pare (I): "*Eksperti sqaron se duke u nisur nga kërkesa e AK-së dhe në ndërlidhje me opinionin e mësipërm të KRPP-së, përcaktimi për kontrata të ngjashme është kompetencë e AK-së, përkatësisht njësisë kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, të përcaktojnë cilat janë kontrata të ngjashme. Më tej është evidente se OE i rekomanduar ka paraqitur së paku një kontratë që është e ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit dhe ka kodin e klasifikimit sipas fjalorit të përgjithshëm të prokurimit për kontratat publike të njëjte me këtë aktivitet (93000000-8) për të cilin ka dorëzuar referencë për përmbushje të suksesshme të kontratës. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar, për faktin se OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmi se ka kryer me sukses së paku një kontratë në tre vitet e fundit, e që plotëson kërkesën e AK-së lidhur me shërbime të ngjashme."

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2 : "AK në këtë aktivitet të prokurimit ka përcaktuar llojin e kontratës kontratën publike kornizë me një operator ekonomik. Sipas përshkrimit në dosjen e tenderit, janë gjithsej 39 gjenerator, dhe për secilin pozicion në listën e çmimeve është vendosur sasia 1 dhe aplikohet procedura e poentimit të çmimeve. Në listën e çmimit, pozicioni "40.pompa e vajit -komplet" është paraqitur në 29 pozicione. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar formularin e çmimeve ku ka ofertuar për 29 pozicione me çmimin 490.00 euro. OE ankues ka bashkangjitur si provë Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 23.08.2023 lidhur me aktivitetin paraprak në lidhje me këtë shërbim, ku OE ankues si ofertues i vetëm është eliminuar. Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 23.08.2023, AK i referohet sqarimeve shtesë gjatë vlerësimit ku njëra ndër kërkesat për sqarime drejtuar OE ankues ishte: "Ju si operatori ekonomik qe keni konkurruar, te pozicioni 40. Pompa e vajit — komplet keni ofruar çmimin 550 euro. A mendoni se te gjithë gjeneratorët pavarësisht madhësisë apo kapacitetit te tyre a e kanë pompën e njëjtë apo te ndryshme?". Ndërsa OE ankues ishte përgjigjur: "1. Për pozicionin pompa e vajit komplet kemi dhënë çmimin 550 euro, Gjeneratorët i kane pompat e ndryshme por qe çmimi i tregut është përafërsisht i njëjtë. Ne çmim është përfshirë, furnizimi, montimi përfshire edhe garancioni. Ne do te japin garancinë dhe zëvendësim me te re ne rast se pompa prishet gatë periudhës garantuese te cekur ne dosjes, prandaj është dhënë ky çmim.".

Konstatimi i dytë (II): "Eksperti fillimisht sqaron se OE ankues nuk ka precizuar se çmimi i ofertuar është jo normalisht i ulët por pretendimi ka të bëjë me trajtimin jo të barabartë ku OE ankues deklaron se në aktivitetin paraprak të anuluar nga AK është eliminuar për arsye të njëjtë se ka ofruar çmim të njëjtë për dallim nga madhësia e gjeneratorëve. Eksperti sqaron se në kuptimin e nenit 7 të LPP-së dhe në ndërlidhje me nenin 59 të LPP-së, AK duhet të trajtojë në

mënyrë të barabartë OE-të duke mos i diskriminuar në një procedurë të prokurimit. Arsyeja e eliminimit të dhënë nga AK në aktivitetin paraprak ishte vetëm njëra nga disa arsyet për eliminim, si dhe sqarimi i dhënë nga OE ankues në aktivitetin paraprak është kundërthënëse me pretendimin në këtë aktivitet, për shkak se vet OE ankues përmes deklaratës për sqarimin e tenderit ka konfirmuar se gjeneratorët i kane pompat e ndryshme por qe çmimi i tregut është përafërsisht i njëjtë, ndërsa në këtë ankesë OE ankues pretendon se nuk mund të kenë çmime të njëjtë për gjeneratorët me madhësi të ndryshme. Eksperti sqaron se OE-të kanë mjetet juridike në dispozicion për secilën procedurë dhe në aktivitetin paraprak OE nuk ka kundërshtuar vendimin e AK-së sipas regjistrit të ankesave në OSHP. Në lidhje me çmimin e pozicionit "40.pompa e vajit-komplet" në këtë aktivitet të prokurimit, sipas nenit 41 të RRPP, nëse për AK çmimet duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, atëherë AK zbaton procedura të sqarimit të çmimeve me OE kur plotësohen kushtet procedurale. Në këtë rast kur AK ka konsideruar se çmimet janë të besueshme dhe OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë provë se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së apo Rregullores për Prokurim Publik, eksperti vlerëson se nuk ka prova që veprimet e AK-së bien ndesh me dispozitat e LPP-së apo RRPP, në mënyrë që të rekomandoj Panelin Shqyrtues të obligojë AK-në të kërkojë sqarime shtesë nga OE i rekomanduar. Andaj, duke u bazuar në provat shkresore në dispozicion lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, pretendimi ankimor është i pabazuar."

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 3: "AK me datë 8.12.2023 ka njoftuar OE ankues përmes letrës standarde si tenderues i pasuksesshëm, duke e njoftuar se tenderi i është dhënë OE LIRIA SH.P.K ne vlerë totale te ofertës 40249.64 euro. OE ankues me datë 13.12.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimin e njëjtë ankimor (pretendimi ankimor 2) si në këtë ankesë. Në pretendimin ankimor 3 OE ankues pretendon se është bërë trajtim i pabarabartë në kuptimin e veprimit të AK-së në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. AK me datë 18.12.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Në vendim janë dhënë përgjigjet për dispozitat e LPP-së (Nenet 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së) për të cilat OE ankues ka pretenduar që janë shkelur nga AK. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 7, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "Pika e ankesës lidhur me nenin 7 te LPP-se nuk qëndron pasi AK-SHKK ka here vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ne mënyrë te argumentuar, te drejte dhe korrekte duke trajtuar te gjithë OE pjesëmarrës ne mënyrë te barabartë duke vlerësuar me kujdes te gjithë dokumentacionin e dorëzuar ne plotësimin e secilës kërkesë dhe kriter ne dosje, prandaj ka konstatuar edhe njëherë se oferta ankuese nuk është me çmim me te lire dhe se është mbi vlerën e parashikuar te kontratës." Në lidhje me vendimin e AK-së në raport me kërkesën për rishqyrtim Neni 108, paragrafi 9 i LPP-së përcakton "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. […]"

Konstatimi i tretë (III) :"Eksperti vlerëson se AK ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, konform nenit 108 paragrafi 9 i LPP-së, ku ka dhënë arsyetim për dispozitat e LPP-së për të cilat OE ankues ka pretenduar që janë shkelur nga AK. Megjithatë, në arsyetimin e

vendimit të kërkesës për rishqyrtim AK ka precizuar "….oferta ankuese nuk është me çmim me te lire dhe se është mbi vlerën e parashikuar te kontratës". Pra AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim vendos arsye të eliminimit, përkundër që të njëjtat nuk janë përmendur në vendimin e AK-së përkatësisht në letrën standarde për OE ankues. Në këtë kuptim ashtu sikurse kërkohet me nenin 54 të LPP-së, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 ku thuhet: "në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat" eksperti sqaron se në kuptimin procedural secila arsye e eliminimi duhet të precizohet në letre standarde për tenderuesin e eliminuar dhe duhet ti jepet mundësia OE-ve që të realizojnë të drejtën e kërkesës për rishqyrtim për arsyet e eliminimit. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues"AS Tech Sh.P.K." Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech Sh.P.K."janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjore" me nr. të prokurimit: "33600-23-12202-2-2-1".

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht të bazuar.Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur duke u mbështetur në raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirembajtja e gjeneratorve ne institucionet e Shërbimit Korrektues te Kosovës dhe Instituti te Mjekësisë Ligjore" me nr. të prokurimit: "33600-23-12202-2-2-1", dhe të mbetet ne fuqi Vendimi i AK-së.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: